



PEC: federazionefnai@pec.it
Mail : federazione.fnai@gmail.com
Facebook: FNAI - Federazione Nazionale delle Associazioni Albanesi in Italia
IBAN: IT05S0501801600000016677916
C.F : 91378810377

Verona, 21 mars 2021

Prot. N. 103/2021

Dërgohet me poste ose e-mail

DREJTUAR

Z. Edi Rama – Kryeministria

Bulevardi Dëshmorët e Kombit

Tiranë 1010, Albania

Znj. Olta Xhaçka - Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtëme

Bulevardi 'Gjergj Fishta', Nr 6

Tiranë 1000, Albania

Z. Pandeli Majko – Ministri i Shtetit për Diasporën

Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr. 1

Tirana 1000, Albania

Subjekti: Njohja e të drejtës për pension: kërkesa për nisjen e negociatave dhe realizimin e marrëveshjes dy palëshe Itali-Shqipëri ose për futjen e një akti rregullator specifik.

Mund të duket e tepërt të kujtohet përparësia e komunitetit shqiptar të Italisë për sa i përket ndërveprimit socio-ekonomik si dhe, anasjelltas, nënvizimi i pranisë masive të qytetarëve italianë që janë banorë të përhershëm në Shqipëri. Nga ana tjetër, është thelbësore të theksohet sa më lart kur flitet për pretendimin e të drejtave themelore siç janë pensionet, domethënë njohja reciproke dhe grumbullimi i viteve të punës në bazë të kontributeve të paguara në vendet e tyre përkatëse të origjinës nga komunitetet e lartpërmendura.

Çështja e pensioneve nuk është një risi as për Italinë, madje as për Shqipërinë pasi të dy shtetet tashmë kanë nënshkruar marrëveshje dy palëshe mbi pensionet me vende të tjera të ndryshme të botës, përkundrazi bëhet fjalë për t'i dhënë problemit vëmendje dinjitoze.

Kartat kushtetuese të dy vendeve promovojnë parimin e barazisë dhe trajtimin e barabartë, duke mbrojtur në mënyrë të njëjtë të drejtën për pension: mohimi i të drejtës për njohjen e viteve të kontributeve me qëllim të përlllogaritjen e vjetërsisë së pensionit në vendet përkatëse të origjinës, shihet si një akt i padrejtë shoqëror dhe prandaj po bëhet, ditë pas dite, një betejë për dinjitetin njerëzor.

U krijua një peticion mbi këtë temë, i cili deri më sot ka mbledhur 11094 nënshkrime dhe të gjitha shoqatat shqiptare në Itali po mobilizohen në çdo mënyrë për të rritur ndërgjegjësimin e publikut. Inercia e politikës përplaset në mënyrë të pashmangshme me këtë valë pakënaqësie mes qytetarëve shqiptarë në Itali, tani, në pjesën më të madhe, mbajtës të shtetësisë së dyfishtë.

Federata Kombëtare e Shoqatave Shqiptare në Itali, që përfaqëson shoqatat që i përmbahen asaj, kërkon që marrëveshja dy palëshe Italo-Shqiptare të negociohet dhe miratohet në një kohë të shpejtë në mënyrë që të garantojë punëtorët që nuk e kanë - nga të dy vendet - njohjen e duhur të së drejtës themelore dhe të mbrojtur me kushtetutë: pensionin. Opsioni alternativ, i cili nuk do të linte vend për asnjë justifikim nga ana e "vendit të kundërt", do të ishte zgjedhja e njëanshme e miratimit të një mase rregullatore ad hoc, kombëtare.

Në pritje të një përgjigje ndaj kërkesës sonë, e shfrytëzojmë këtë mundësi për të shprehur përsëritetjet tona të përzemërta, duke shprehur gatishmërinë tonë për një takim.

Federata Kombëtare e Shoqatave Shqiptare në Itali

Presidente

Dr. Margita Hoxha